



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1440/13 prot.

Datë 24.07.2025

V E N D I M

Nr. 951/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.07.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.883/2025, datë 10.07.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, mallra”, me nr. REF-41770-03-19-2025, me objekt: “Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës”, me fond limit: 36,666,500 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH dhe 369,472.99 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH. *Shënim: Vlerat në Lekë në këto dokumente tenderi janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 19.03.2025, me kurs këmbimi 99.24 (nëntëdhjetë e nëntë pikë njëzet e katër) lekë, zhvilluar me datë 02.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

BOE “Gentian Sadiku” P.F. (përfaqësues) me NIPT L42314005A dhe me adresë Rruga “At Zef Pllumbi”, pallati nr.16 "Devi 2001", pasuri Nr. 39/118-n10, zona kadastrale 2679, vol 31, Mezez, Tiranë & “KRISTAL 2001” Shpk.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara. me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 10.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.883/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Gentian Sadiku” P.F. (përfaqësues) & “KRISTAL 2001” Shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, mallra”, me nr. REF-41770-03-19-2025, me objekt: “Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës”, me fond limit: 36,666,500 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH dhe 369,472.99 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH. *Shënim: Vlerat në Lekë në këto dokumente tenderi janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 19.03.2025, me kurs këmbimi 99.24 (nëntëdhjetë e nëntë pikë njëzet e katër) lekë, zhvilluar me datë 02.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të BOE “Gentian Sadiku” P.F. (përfaqësues) & “KRISTAL 2001” Shpk, të korrigjojë shkeljet e konstatuara duke ekualifikuar këtë BOE, si dhe të kryejë veprimet procedurale në lidhje me zbatimin e konstatimeve të mësipërme.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Gentian Sadiku” P.F. (përfaqësues) & “KRISTAL 2001” Shpk.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 906/17 prot., datë 16.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1440/10 prot., datë 17.07.2025, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 883/2025, datë 10.07.2025, si vijon: “...Autoiteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 883/2025 prot., datë 10.07.2025 të KPP_së, duke bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar në SPE , sipas procesverbalit bashkëlidhur”.
-procesverbal me datë 16.07.2025 mbi rivlerësimin e ofertave të paraqitura, nga KVO;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 906/17 prot., datë 16.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1440/10 prot., datë 17.07.2025, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 883/2025, datë 10.07.2025, si vijon: “...Autoiteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 883/2025 prot., datë 10.07.2025 të KPP_së, duke bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar në SPE , sipas procesverbalit bashkëlidhur”.
-procesverbal me datë 16.07.2025 mbi rivlerësimin e ofertave të paraqitura, nga KVO;

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka rivlerësuar BOE “Gentian Sadiku” P.F. (përfaqësues) & “KRISTAL 2001” Shpk në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.883/2025, datë 10.07.2025, duk e kualifikuar këtë ofertues. Këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me anë të procesverbal me datë 16.07.2025 mbi rivlerësimin e ofertave të paraqitura, të nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, mallra”, me nr. REF-41770-03-19-2025, me objekt: “Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës”, me fond limit: 36,666,500 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH dhe 369,472.99 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e nëntë) Euro

pa TVSH. *Shënim: Vlerat në Lekë në këto dokumente tenderi janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 19.03.2025, me kurs këmbimi 99.24 (nëntëdhjetë e nëntë pikë njëzet e katër) lekë, zhvilluar me datë 02.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

